



Funded by the
European Union

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky është një publikim jozyrtar i destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

VENDIM

Nr. 45, datë 29.1.2014

PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TË FONDIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE DHE ISH-INSTITUCIONEVE KËRKIMORE-SHKENCORE TË KËSAJ MINISTRIE, AKTUALISHT NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15, shkronja "c" të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore me sipërfaqe 18 076 (tetëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) ha të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, e cila aktualisht është në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2. Sipërfaqet e tokave bujqësore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të administrohen sipas ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", të ndryshuar, ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat" dhe vendimit nr. 460, datë 22.5.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit".

3. Shkronja "c" e pikës 1 të vendimit nr. 567, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për caktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik"; vendimi nr. 868, datë 18.6.2008 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore"; pika 1 e vendimit nr. 459, datë 22.5.2013 të Këshillit të Ministrave "Për një

Ministria e Drejtësisë,
Bolevardi "Zogu I"
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 22 40 333
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu



ndryshim në fondin e kompensimit fizik të krijuar nga fondi i tokës bujqësore”; urdhri nr. 265, datë 1.10.2002 i Kryeministrit “Për evidentimin dhe ndërprerjen e procedurave të tjetërsimit ose dhënies me qira të pronës shtetërore, tokë bujqësore, pyjore livadhe dhe kullota”, dhe urdhri nr. 287, datë 20.12.2006 i Kryeministrit “Për evidentimin dhe ndërprerjen e procedurave të tjetërsimit të pronës shtetërore, tokë bujqësore, livadhe dhe kullota”, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama